

BIBLIOTEKA E RINISË

KOÇO TITKA - ADRIATIK KANANI

RINIA
E AKSIONIT
TË PARË



8JH32

T72

814-32

TR

BIBLIOTEKA E RINISË

KOÇO TITKA — ADRIATIK KANANI

3085

BIBLIOTEKA E SHKOLLËS
GJYKONIS

RINIA E AKSIONIT
TË PARË

~~38042~~

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

«S'mund të kuptohet dhe as që mund të mbrihet rindërtimi i Shqipërisë pa pjesëmarrjen e gjerë të rinisë. Shqipëria e re ndërtohet për rininë tonë, për brezat e ardhëshëm, prandaj ajo duhet të lozë rolin kryesor në ndërtimin e atdheut, që është ndërtimi i jetës së saj të lumtur. Këtë gjë rinia jonë heroike e ka merituar plotësisht... Qeveria, me besimin më të madh, e ngarkoi rininë të ndërmarrë dhe të drejtojë vetë të gjitha punimet që do të bëhen në rrugën Peshkopi-Bicaj. Rinia më ka dhënë fjalën se do ta kryejë këtë gjë dhe unë e di, pse e kam provuar në momentet më të rrezikëshme që kalonte atdheu, se rinia s'e bën kurrë fjalën dysh».

ENVER HOXHA

NE VËND TË HYRJES

Në rrugën automobilistike që shkon për në Peshkopi, në krah të majtë të urës së Muhurit mbi lumin Drin, udhëtarit do t'i zerë syri një pllakë, ku lexohet ky mbishkrim:

«Më 1 Qershor 1946 filluan punimet
2500 të rinj, nga të katër anët e
Shqipërisë, për ndërtimin e rrugës
së rinisë Kukës-Peshkopi, simbol i
dashurisë së rinisë sonë për atdheun.»

Kjo pllakë u kujton kalimtarëve një ngjarje, e cila nuk do të harrohet ndoshta për shekuj. Njëzet vjet më parë, në këtë vend u bë inaugurimi i veprës së madhe. Për herë të parë automjetet çanë drejt shtigjeve të egra të malësisë, për herë të parë në ato anë u dëgjua boria e maqinave. Dhe nuk do ta tepëronim aspak nëqoftëse do të thoshim për herë të parë qindra e mijra banorë të fshatrave të atyre anëve shikonin automjet.

Ky është vetëm fillimi i tregimit tonë. Sa djersë dhe sakrifica janë dashur për këtë vepër. Ajo simbolizon një etapë të tërë. Ne na duhet të kujtojmë dhe të rikujtojmë ato ditë të paharruara të vitit 1946, kur njerëzit e rinj thurnin, si ajo bleta punëtore, veprën e tyre. Ky qe shpër-

thimi i parë i madh i rinisë sonë, pas stuhisë revolucionare të Luftës Nacional-Çlirimtare. Veprat e ndërtimit tek ne ndoqën njëra-tjetrën. Çdo njëra prej tyre ka madhështinë e vet, heronjtë e saj, por rruga Kukës-Peshkopi qëndron mbi të tjerat, jo për rëndësinë se sa për heroizmin e atyre që e ndërtuan. Mbas një kohe kaq të gjatë, prej dy dekadash, ne na duhet të kujtojmë me moshatarët dhe shokët tanë të punës vitin 1946, të lexojmë ndonjë letër që na ka ngelur, dokumenta që i përkasin asaj periudhe, ditarin e ndonjë vullnetari, të kthehemi përsëri në valën e ngjarjes së madhe, në krahinat e thella të malësisë së veriut, të bisedojmë me dibranë e kuksjanë, ish vullnetarë, flokët e të cilëve tashmë kanë filluar të zbardhen, për t'u dhënë lexuesve një ide për rrugën Kukës-Peshkopi.

Ngjarjet nuk lënë të njëjtën mbresë te njeriu. Kujtimet e rinisë ruajnë bukurinë dhe ëmbëlsinë e tyre. Ato skaliten thellë dhe nuk errësohen, ndonëse pasohen nga dhjetra të tjera. Ne, si dëshmitarë, pjesëmarrës në ndërtimin e kësaj vepre, nuk do të harrojmë kujtimet tona.

Viti 1946... Shqipëria kishte hyrë në vitin e dytë të çlirimit. Pushteti popullor porsa kish filluar të bënte hapat e para në jetë dhe, natyrisht, ato i hidhte si ajo fëmija që ecën mengadalë, por me besim se në të ardhmen do të ecë më mirë. Madhështia e rrugës së rinisë nuk mund të kuptohet jashtë kohës dhe rrethanave, në të cilat u ndërtua. Në vitin 1946 ende nuk ishin shëruar plagët e luftës. Gërmadhat dukeshin kudo. Pamja e fshatit tonë ishte e vajtueshme. Armiku kishte mbjellë urinë dhe mjerimin. Vitet 1945-1946 kanë qënë vitet e përpje-

kjeve dhe të sakrificave të mëdha për të shëruar plagët që na ishin shkaktuar nga pushtonjësit fashistë.

Atëhere nuk kish rrugë hekurudhore. Jo vetëm kaq, por edhe rrugët automobilisteke nuk ishin në rregull. Ato ishin dëmtuar gjatë viteve të luftës. Mjaft ura ishin shkatërruar. Rindërtimi i shtëpive të djegura dhe shkollave në fshatra kërkonte lëndë ndërtimi. Mbi lumenjtë e mëdhenj Vjosë, Shkumbin e Drin automjetet kalonin mbi trapa. Shqipëria ishte në periudhën e rimëkëmbjes së saj, e rindërtimit nga shkatërrimet e luftës, gjurmat e së cilës i shikojë gjithkund.

Partia jonë, qysh në kohën e luftës, e kishte bërë të qartë se, fill pas çlirimit të vendit nga pushtonjësit fashistë dhe vendosjes së pushtetit popullor, **popullit tonë do t'i delte përpara një betejë e re** — ajo e rindërtimit dhe ndërtimit të vendit. Partia, duke u udhëhequr nga mësimet e Leninit të madh, e kishte parasysh se marrja e pushtetit nuk ishte mbarimi i luftës, sikundër ndodh me revolucionet borgjeze, por vetëm fillimi i një beteje edhe më të madhe për t'i çuar deri në fund fitoret e mëdha të revolucionit popullor. Ndërtimi i rrugës Kukës Peshkopi, si shumë e shumë vepra të tjera që ndërmori pushteti ynë, nuk ishte një gjë e rastit, por bënin pjesë në programin minimal të partisë për ndërtimin e vendit të shkatërruar nga lufta dhe për ndërtimin e socializmit.

Populli shqiptar, ashtu si gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare, iu përgjegj thirrjes së partisë dhe i hyri rrugës së transformimeve të mëdha revolucionare, për ndërtimin e jetës së re. Nga të katër anët e vendit, populli ynë, i ndërgjegjshëm dhe me besim në forcat e veta, iu përvesh punës me

një hov të ri patriotik. Dhe në këtë betejë të dytë të popullit tonë Rinia popullore e Shqipërisë lojti një rol të madh.

Në këto kushte të vështira për vendin, pushteti ynë popullor ndërmori një aksion të tillë kaq të madh, siç ishte rruga Kukës-Peshkopi, vepër që ai ja besoi rinisë sonë heroike.

Në fjalimin programatik të 25 marsit 1946, udhëheqësi i shquar i popullit tonë, shoku Enver Hoxha, deklaroi në sesionin e Kuvendit Popullor:

«Vendi ynë ka nevojë për rrugë të reja, të mëdha, ose të vogla, për këtë qëllim Qeveria ka në programin e vet jo vetëm ruajtjen e atyre që kemi, por të hapim edhe rrugë të reja. Në Jugë dhe në Veri punime në këtë kuptim kanë filluar. Duhet, sigurisht, një periudhë e gjatë derisa ne të mundim të ndërtojmë një rjetë rrugësh të përsosur, por duhet të fillojmë që këtë vit të ndërtojmë rrugën në krahinat veriore, me qëllim që t'u vimë në ndihmë fshatarëve të atyre krahinave dhe të kontribuojmë në ngritjen e nivelit të jetës ekonomike dhe kulturele të popullit në zonat veriore».

Sekretariati i Këshillit të Përgjithshëm të BRASH-it, për t'iu përgjigjur programit të qeverisë, në mbledhjet e 13-14 majit 1946, në të cilën merrnin pjesë edhe kuadro të organizatës së rinisë të të gjitha rrethëve, vendosi që rinia të marrë përsipër aksionin e madh — ndërtimin e rrugës Kukës-Peshkopi. Më 18 maj 1946, Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë, në përgjigje të propozimit të Sekretariatit të Këshillit të Përgjithshëm të BRASH-it, mori këtë vendim:

«Në mbledhjen e tij të djeshme, Këshilli i Ministror vendosi çeljen e rrugës që do të lidhë Pesh-

Rruga e Përmirësimit

KUKËS - PESHKOPË



kopinë me Kukësin. Kjo rrugë ka një gjatësi prej 65.400 m. dhe fillon nga ura e Muhurit mbi lumin Drin, vazhdon në të majtë të Drinit 33.800 m. deri në vendin Doda, ku kalon Drinin dhe vazhdon në të djathtë të tij, deri në Kolesjanë dhe Bicaj, ku do të takohet me rrugën që vjen prej Kukësi.

Traseja e kësaj rruge është hartuar në mënyrë që të mos ketë rrezik mbytje në dimër. Kuota në e lartë do të jetë 770 m, ndërsa kuota e nisjes është 385 m. dhe ajo e mbarimit 587, dmth kuota mesatare e kësaj rruge do të jetë rreth 500 m.»

Partia dhe qeveria i besuan rinisë sonë heroike ndërtimin e kësaj vepre të madhe. Sekretariati i Këshillit të Përgjithshëm të BRASH-it iu drejtua atëhere rinisë me këtë thirrje:

«Të rinj dhe të reja të Shqipërisë!

I gjithë populli është hedhur me vull në rindërtimin e vendit për ngritjen e Shqipërisë së re, për të krijuar një jetë më të lumtur.

Rinia qëndron në radhët e para të kësaj pune ndërtimore. Me garat e 1 Majit, një valë entuziazmi përfshiu gjithë rininë tonë dhe kjo pasqyrohet kudo. Ne jemi të bindur se me një punë të tillë ndërtojmë të ardhmen tonë, Shqipërinë e re, prandaj duhet të hedhim tërë energjitë tona për këtë qëllim.

Shokë të rinisë,

Sot marrim përsipër një aksion të madh: rrugën Kukës-Peshkopi, marrim përgjegjësinë për organizimin e gjithë punës, veç anës teknike, duke vënë edhe forcat

vullnetare prej 2500 të rinjve në turnin e parë e po aq të tjerë në turnin e dytë.

Rruga Kukës-Peshkopi ka një rëndësi të madhe për Veriun dhe për gjithë Shqipërinë. Me këtë aksion do t'u japim jetë qindra fshatrave, që regjimet e kaluara i kishin braktisur dhe lënë në errësi.

Komandanti tha në Kuvendin Popullor që duhen ndrequr rrugët e Veriut. Ne sot i përgjigjemi Komandantit, duke marrë përsipër këtë aksion të madh.

Detyra të mëdha na vihen përpara. Janë 65 kilometra rrugë, mijra ditë pune, mijra metër kub dhé e shkëmb për t'u gërmuar. Ka vështirësi, por ne do t'ja dalim në krye, në një kohë më të shkurtër se sa është parashikuar.

Të rinj të Shqipërisë,

Tregoni edhe një herë forcën tuaj, merrni pjesë me shumicë në brigadat e punës që do të punojnë në rrugën Kukës-Peshkopi, shkoni vullnetarë. Le të jetë ky aksion vendi ku ne do të tregojmë forcën e organizatës sonë, dashurinë për popull e atdhe.

Formoni brigadat e punës me të rinjtë më të mirë që janë dalluar më tepër në punë. Ata që do të vinë aty, duhet të jenë të denjë që t'ju përfaqësojnë përpara gjithë rinisë së Shqipërisë.

Të rinj e të reja, punëtorë, fshatarë dhe studentë.

Dita e 1 Qershorit le të jetë dita në të cilën të inaugurojmë punën për rrugën